



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

PRILL, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin prill 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit prill 2024 zënë 31.4 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 151.6/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.1/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin prill 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin prill 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste prill 2024	Incidenca prill 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	7	0.2
Shigelozë (Disenteri bacilare)	13	0.5
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	89	3.1
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	4233	147.9
Sëmundje diarreike në total	4342	151.69

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit prill 2024 janë raportuar në total 176 raste variçelë (incidenca 6.15/ 100.000 banorë) nga të cilat, 76 raste janë të dyshuara dhe 100 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 84 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 89 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, prill 2024




2.2 Fruthi

Fruthi

Gjatë muajit prill janë raportuar 10 raste si të dyshuara me fruth, nga të cilat janë konfirmuar 2 (20%) raste nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin prill është 0.07 raste/100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidencë sipas muajve



Vërehet një trend i qëndrueshëm në dy muajt mars- prill të vitit 2024.

Të dy rastet e konfirmuar janë banorë të bashkisë Tiranë, nuk janë të shtruar në spital, i përkasin gjinisë mashkull. Rastet janë të grup-moshës pediatrike nën 1 vjeç, të pavaksinuar për shkak të moshës së vogël.

2.3 Pertusis

Gjatë muajit prill 2024 janë raportuar 83 raste të dyshuar me Pertus. 37 (44.6) e rasteve janë femra dhe 46 (55.4%) janë meshkuj. Mosha mediane e rasteve është 1.4 vjeç me IQR 0.3 – 10.9 vjeç. Në moshën 0-1m janë (14.5%) e rasteve, në moshën 2-3m janë (24.1%) e rasteve, në moshën 4-5m janë (10.8%) dhe në moshën 6-8m janë (7.2%) e rasteve.

Në grup-moshën <1 vjeç janë (56.6%) e rasteve, në grup-moshën 1-4 vjeç janë (19.3%), në grup-moshën 5-9 vjeç janë (12%), në grup-moshën 10-14 vjeç janë (9.6%) e rasteve dhe ≥15 vjeç janë (2.4%) e rasteve. Nga shenjat klinike mbizotëron kollë e shpeshtë me aksese mbytëse të shkurtra dhe temperaturë. Shumica e rasteve (55.4%) janë raportuar nga spitali pediatrik QSUT ndjekur nga Klinika “Sulçebe”, Tiranë (16.9%). Të hospitalizuar kanë qenë 56 raste (67.5%) e totalit. 47 nga 56 rastet e hospitalizuara ose 84% e të hospitalizuarve janë të moshës <1 vjeç.


Vërehet që 56.6% e rasteve banojnë në Tiranë ndjekur nga Durrësi (7.2%) dhe Elbasani (6%). 28 (33.7%) raste janë konfirmuar për Pertus, nga të cilat 25 me serologji dhe 3 me rRT-PCR. Negative me rRT-PCR kanë rezultuar 8 (9.6%), ndërsa 47 (56.6%) raste janë të dyshuar klinikisht. Shumica e rasteve janë të vaksinuar sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. 18.3% e rasteve janë të pavaksinuar. Për çdo rast është kryer hetimi epidemiologjik dhe evidentimi i kontakteve nga NJVKSH pëkatëse.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin prill janë raportuar 9 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në muajin prill është 0.3 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve




Të gjitha rastet në muajin prill i përkasin grup-moshës adulte nga 35-70 vjeç, janë banorë nga bashkia Dibër (2), Durrës (3), Elbasan dhe Përmet (1), Gjirokastrë dhe Lushnjë (2), Tiranë (3) dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin prill janë raportuar 9 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV në nivel kombëtar për muajin prill është 0.3 raste/100 000 banorë. Të gjitha rastet në muajin prill i përkasin grup-moshës adulte 27-83 vjeç, banorë të bashkive Durrës (5), Elbasan dhe Lushnjë (10) dhe Tiranë (2).


Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve



4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit prill 2024 janë kryer 57 ekzaminime (25 meshkuj dhe 32 femra) për HIV prej të cilave 19 raste (14 meshkuj dhe 5 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv (1 prej të cilëve është fëmijë nën moshën 18 muaj dhe do të mbahen në ndjekje).

Grafiku 5. Shpërndarja e testimeve dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është: Tiranë 13 raste, 3 raste në Durrës, Korçë 1 rast dhe Pogradec 1 rast.

Grafiku 6. Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas Bashkive



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 0-4 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 16-24 vjeç, 6 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 5 raste grup-moshës 34-45 vjeç dhe 6 raste i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 3 raste nga Infektivi, 2 raste nga Sanatoriumi, 6 raste vijnë nga laboratorë privat (Lab Cambridge- 2 raste, dhe nga 1 rast vjen respektivisht nga Spitali Gjerman, Spitali Continental, laboratori INTERMEDICA dhe Laboratori Harrison), 1 rast vjen nga pediatria QSUT, 1 rast referohet nga Urgjenca QSUT dhe 2 raste janë diagnostikuar si pasojë e ndjekjes epidemiologjike, 1 rast është referuar nga QKTGJ dhe 1 rast është referuar nga shoqata ALGBT.

Gjatë muajit prill 2024 janë raportuar 5 raste të konfirmuar Sifiliz, 3 raste janë nga Tirana, 1 nga Korça dhe 1 nga Durrësi

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit prill 2024 janë raportuar gjithsej 22 raste me turbekuloz (TB) pulmonar. Nuk ka raste ekstrapulmonare. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Një prej tyre është recidiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 8 në Tiranë, 3 në Shkodër, 2 në Pukë dhe 1 në Mirditë, 1 në Mat, 2 në Lezhë, 1 në Kavajë dhe 4 në Durrës. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re, dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh, por në shtrirje rastet janë pothuasje në gjithë vendin.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin prill 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecioze)

	Prill (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	1	0.03
Brucelozë	7	0.24
Leptospirozë	0	0.00
Rikecioza të tjera	2	0.07


Për muajin prill është raportuar 1 rast i konfirmuar me Antraks nga NJVKSH Gjirokastër, 2 raste Rikecioze nga NJVKSH Elbasan, dhe 7 raste Brucelozë përkatësisht 3 nga NJVKSH Gjirokastër, 1 nga NJVKSH Bulqizë, 2 nga NJVKSH Dibër dhe 1 nga NJVKSH Shkodër.

7 Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit prill 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 17 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin prill është 0.59 raste /100000 banorë.

Grafiku 7. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 1.22 raste për 100000 banorë, e ndjekur nga grup-mosha 15-24 vjeç me incidencë 0.92 raste për 100000 banorë.

Grafiku 8. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive




Bashkitë me incidencë më të lartë janë Rrogozhin, Skrapar, Belsh etj.

Gjatë muajit prill 2024 është raportuar 1 rast i shtruar në spital dhe asnjë rast vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 6% (1 rast) në ISHP dhe 94% (16 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.2 Grip

Gjatë muajit prill janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 35 raste të konfirmuara me grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin prill është 1.22 raste /100000 banorë. Grafiku 9 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit tipi B.

Grafiku 9. Tipi i viruseve qarkulluese



Në muajin prill qarkullimi i gripit paraqet aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI